



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P. nr.972/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit: G.P nga ..., për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.532/2018, të datës 14.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 23.09.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasa Tanic dhe të pandehurit, në po të njëjten ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 30.09.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.P, nga i ati S., e ëma S., e vajzërisë H., i lindur me datë ... në fshatin ... – komuna e ..., tani me venbanim në rr. “...” pnr. ..., i pa punë, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të përfunduar shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 08.12.2016 , rreth orës 11:00, në ..., në rrugën “...”, seriozisht i ka kanosur me fjalë personat zyrtarë – të dëmtuarit H.T dhe B.P – punëtorë këta të Ndërmarrjes për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, në lidhje me punën të cilën ata e kryenin, se do t’u shkaktoj lëndime me qëllim të frikësimit të të dëmtuarve, duke marrë parasysh se më heret në vendin e cekur e kanë çkyçur energjinë elektrike për shkak të borxhit të papaguar dhe për këtë arsye e ka telefonuar të dëmtuarin H.T duke i thënë: “nanen jau qifsha se veq mos ju nxofsha se ty e B. e di unë çka ju boj”, duke shkaktuar frikë tek të njëjtit.

Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosje nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 49, 50, 51 , 52, 73, e 74 e 185 të KPRK-se, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 40€, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Pala e dëmtuar, H.T dhe B.P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.532/2018, të datës 14.11.2018, ndaj të pandehurit G.P nga ..., për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, jam thellësisht i penduar për këtë që ka ndodhur, kam qenë pak nervoz, e di që jam ngutur por premtoj që në të ardhmen nuk do ta përsërisë edhe ashtu shumë shpesh takohem me këta dhe nuk kemi asnjë problem, jam mbajtës i familjes, jetoj vetëm nga të ardhurat që realizoj nga puna ditore, prandaj e lus Gjykatën që t'i marrë parasysh këto rrethana.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është i bazuar në ligj dhe në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit t'i merr parasysh të gjitha rrethanat.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri G.P, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor me nr. të serik ..., të datës 08.12.2016; Deklarata e të pandehurit G.P dhënë në polici, e datës 08.12.2016; Deklarata e të dëmtuarit H.T dhënë në polici, e datës 08.12.2016; Deklarata e të dëmtuarit B.P dhënë në polici, e datës 08.12.2016. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Kanosje nga neni 185 par.3

lidhur me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë për veprat penale, faktin se i njëjti ka shprehë keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, faktin se nga ndodhja e rastit kanë kaluar një kohë rreth 3 vjet, e që bëhet fjalë për kanosje, dhe rrethanat personale ngase i njëjti është mbajtës i familjes, i pa punë, çka për gjykatën rezulton të jetë i gjendjes ekonomike të dobët. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata e vlerësoj mënyrën dhe rrethana se si ka vepruar duke pasur parasysh se kjo veprë penale ka qëllim ta mbrojtë integritetin e individit, e sidomos mbrojtjen e personave gjatë kryerjes së detyrave të punës.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandaloje kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.972/2018 dt.30.09.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.